



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË
Nr. 172 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KONKURENCËS
Nr. _____ Prot.

AKT - MARRËVESHJE

Në Tiranë, sot, më datë 1.07.2004, lidhet kjo akt-marrëveshje, ndërmjet:

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, i cili më poshtë do të quhet **ILDKP**, i përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, znj. Fatmira Laska;

dhe

Autoriteti i Konkurrencës, i cili më poshtë do të quhet **AK**, i përfaqësuar nga Kryetari, z. Zef Preci.

Të dy subjektet nënshkruese të kësaj akt-marrëveshje, me qëllim:

realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare;

rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe detyrimeve financiare;

koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta institucionale në kuadrin e parandalimit të korrupsionit dhe të luftës kundër tij;

bien dakort si më poshtë:

1. Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje në frymën e nenit 26 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

2. AK angazhohet që të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive çdo informacion apo të dhënë zyrtare

që disponon ky institucion, që lidhen me kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare.

3. AK do të caktojë një person si pikë kontakti me ILDKP, në mënyrë që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

4. Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave do të bëhet në cdo rast me shkresë të Inspektorit të Përgjithshëm. AK merr përsipër që, jo më vonë dhe 15 ditë nga marrja e kërkesës, të vërë në dispozicion të personit të autorizuar nga ILDKP, të dhënat e kërkuara. Në cdo rast të dhënat do të jenë shkresore. Ato duhet t'i përgjigjen drejtpërdrejt kërkesës së bërë dhe nuk duhet të jenë të përgjithshme.

5. Kjo marrëveshje nënshkruhet sot më datë 1.07.2004 dhe fillon zbatimin e saj menjëherë.

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË**

Inspektori i Përgjithshëm

FATMIRA LASKA



AUTORITETI I KONKURENCËS

Kryetari

ZEF PRECI

